



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR. 43 .DATË, 31/05 2022

**“PËR MIRATIMIN E ANGAZHIMIT NË BASHKËFINANCIM NË KUADËR TË
IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT “KONSTRUKSIONI I TREGUT LOKAL ROM
GJIROKASTËR ROMA ON MARKET”**

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, ligjit 68/2017 “Për fianancat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr 09. datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit nr 35, datë 21.09.2020 ” Për kontrollin regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve” i ndryshuar, VKB nr 107 datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022”, si dhe në kuadër të projektit të aplikuar nga Bashkia Gjirokastrë për thirrjen **EU for Municipalities 1st Call for Proposal**, për ndërtimin e një Tregu të ri Rom dedikuar integritit dhe zhvillimit të komunitetit, Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 31/05 2022

VENDOSI:

1. Të autorizojë i Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë për nënshkrimin e marrëveshjes me donatorin.
2. Angazhimin e Bashkisë Gjirokastrë për mbulimin e TVSH-së të infrastrukturës dhe paisjeve si dhe bashkëfinancimit.
3. Angazhimin e Bashkisë Gjirokastrë për akordimin e një fondi në buxhetit afatshkurtër dhe afatmesëm dedikuar mirëmbajtjes së objektit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi

KRYETAR I KËSHILLIT

Sekretar i Këshillit
Etleva Y20

LAVDI HASANI

